



**THIRRJE PËR PJESËMARRJE**  
**KONFERENCA V NDËRKOMBËTARE**  
**"GLOBALIZIMI DHE INTEGRIMI NË EDUKIMIN BASHKËKOHOR"**  
**20 NËNTOR 2026**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" shpall thirrjen e parë për pjesëmarrje dhe bashkëpunim në Konferencën V Ndërkombëtare "Globalizimi dhe integrimi në edukimin bashkëkohor", e cila do të mbahet në **20 Nëntor 2026** në Elbasan.

Transformimet e shpejta teknologjike, digjitalizimi i shoqërisë, inteligjenca artificiale dhe ndryshimet sociale kanë sjellë sfida të reja për sistemin arsimor në Shqipëri dhe më gjerë. Arsimi bashkëkohor po përballlet me nevojën për të zhvilluar aftësi të reja, si mendimi kritik, kompetencat digjitale, siguria online, inteligjenca emocionale dhe aftësia për t'u përshtatur me ndryshimet e vazhdueshme.

Në Shqipëri, procesi i modernizimit të arsimit lidhet ngushtë me integrimin europian, zhvillimin e teknologjisë në shkolla dhe universitete, si dhe me nevojën për të ndërtuar institucione arsimore më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe inovative. Paralelisht, sfida të tilla si përdorimi i pakontrolluar i rrjeteve sociale, bullizmi dhe cyberbullizmi, problemet e shëndetit mendor tek të rinjtë, siguria në shkolla, dezinformimi dhe ndikimi i teknologjisë në zhvillimin psikologjik të fëmijëve dhe adoleshentëve po kërkojnë qasje të reja ndërdisiplinore dhe politika të koordinuara. Në këtë kontekst, konferenca synon të krijojë një platformë kombëtare dhe ndërkombëtare dialogu ndërmjet akademikëve, institucioneve publike, ekspertëve dhe punonjësve arsimorë, psikologëve, profesionistëve të sigurisë, organizatave ndërkombëtare dhe të rinjve për të diskutuar sfidat dhe mundësitë që shoqërojnë transformimin e arsimit në epokën moderne.

**Tematikat kryesore të kësaj konference:**

***Tematika I: Mësimdhënia Inovative dhe sfidat e AI në Sistemin arsimor***

- Mjetet digjitale në edukim- Përdorimi i AI në procesin mësimor
- Teknikat Moderne të Mësimdhënies
- Arsimi i lartë dhe kërkimi shkencor
- Sfidat në formimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve
- Edukimi dhe media

### ***Tematika II Cilësia në Arsim, Vlerësimi dhe Politikat Arsimore***

- Vlerësimi i nxënësve dhe standardet e të nxënësve;
- Reformimi i kurrikulave dhe përshtatja me tregun e punës;
- Ndikimi i proceseve të integritetit evropian në arsimin shqiptar

### ***Tematika III: Trajtimi i problemeve psikologjike përballë tendencave të sotme globale***

- Inteligjenca dhe krijueshmëria
- Shëndeti mendor tek të rinjtë dhe sfidat emocionale
- Edukimi prindëror në mirëqënien psikoemocionale të fëmijëve
- Trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta
- Bullizmi: Strategjitë e menaxhimit dhe trajtimit.

### ***Tematika IV: Edukimi Fizik, Sporti dhe Promovimi i Shëndetit tek të Rinjtë***

- Edukimi fizik dhe shëndeti
- Aktiviteti fizik dhe ndikimi në shëndetin mendor dhe mirëqënien e të rinjve
- Sfidat e edukimit fizik në sistemin arsimor bashkëkohor
- Edukimi shëndetësor dhe promovimi i stileve të jetesës së shëndetshme në shkolla

### ***Tematika V: Shërbimi psikosocial në kontekstin e ndryshimeve***

- Shërbimet sociale inovative në fushën e edukimit
- Problemet psiko-sociale në epokën digjitale
- Transformimet e familjes moderne lidhur me kontekstet kulturore të shoqërisë
- Bashkëpunimi shkollë–familje–institucione sociale në mbështetjen e nxënësve;
- Ndërhyrjet sociale për grupet vulnerabel dhe fëmijët në nevojë;

### **Informacione për pjesëmarrjen në konferencë**

|                                    |                                                                                  |
|------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|
| Dërgimi i abstraktit               | <b>24 Korrik 2026</b>                                                            |
| Njoftimi për pranimin e abstraktit | <b>30 Korrik 2026</b>                                                            |
| Dërgimi i artikullit të plotë      | <b>Tetor 2026</b>                                                                |
| Data e konferencës                 | <b>20 Nëntor 2026</b>                                                            |
| Vendi                              | Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” |
| Gjuha zyrtare e konferencës        | shqip, anglisht                                                                  |
| Tarifa e pjesëmarrjes              | 2,000 ALL për një autor<br>1,000 ALL për çdo bashkautor                          |
| Koha e prezantimit                 | 10-15 minuta                                                                     |
| Adresa zyrtare                     | <a href="mailto:konferenca.fshe@uniel.edu.al">konferenca.fshe@uniel.edu.al</a>   |

**Formati i prezantimit të abstraktit**

- **Emri i autorit:** Emri i plotë i autorit (dhe i bashkautorëve), titulli ose grada shkencore, institucioni, adresa e-mail (12 points Times New Roman).
- **Fusha e studimit:** (sipas tematikave të sipërpërmenduar të konferencës)
- **Abstrakti:** Abstrakti duhet të përmbajë 200-250 fjalë dhe të paraqesë qëllimin dhe metodologjinë e kërkimit, rezultatet dhe rekomandimet (12 points Times New Roman, Justified, Single-space).
- **Fjalët kyçe:** 3-6 fjalë (12 points Times New Roman, Italic).
- **Formati:** Microsoft Word (97-2003).

**Hapat për prezantimin e punimit:**

- Zgjidhni sesionin në të cilin dëshironi të merrni pjesë.
- Dërgoni abstraktin në adresën e-mail: [konferenca.fshe@uniel.edu.al](mailto:konferenca.fshe@uniel.edu.al), duke përcaktuar sesionin e përzgjedhur.
- Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit

**Ju mirëpresim në FSHE, Elbasan!**